



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 86-të të mbajtur më 05.05.2023, miratoi sa vijon.

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-5794/1 të datës 26.12.2019, me pretendime për parregullsi në zbatimin e procedurës falimentuese të /// në falimentim e hapur në vitin 2004, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-5794/1 të datës 26.12.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në ven faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 26.12.2019 është dorëzuar denoncim me pretendime për parregullsi në zbatimin e procedurës së falimentimit të /// dhe është formuar lënda me numër 12-5794/1 të datës 26.12.2019.

Në denoncim, ku nuk tregohen persona dhe ngjarje të veçanta që i referohen veprimeve të veçanta korruptive, parashtruesi paraqet pretendime për disa parregullsi të kryera nga administruesi i autorizuar i falimentimit /// në procedurën e falimentimit kundër /// në falimentim, konkretisht: fshirje të debitorit dhe në llogarinë e falimentimit nga Regjistri Qendror, mosdorëzimi i raporteve mujore për veprimet e ndërmarra në gjykatën kompetente, mosndarja e informacionit të detajuar me kreditorët e falimentimit për rrjedhën e procedurës dhe gjendjen e një pjese të pasurisë dhe pretendimet e debitorit të falimentimit.

Njëkohësisht në denoncim janë theksuar pohime për parregullsi në shitjen e pjesëve hapësinore, makinerive dhe tokës e cila ishte në pronësi të ///.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK konstatoi se pretendimet e denoncuar nuk janë korrupsion sipas përkufizimit të përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe

Konfliktit të Interesit dhe nuk i nënshtrohen veprimeve të saj kompetente, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë .

Duke pasur parasysh sa më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesit të denoncimit

Përpiloi: A.R.M.

miratoi: G.T., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**  
Kryetar  
Biljana Ivanovska

